

DIREKTIVA NR. 96/34/KE, “MBI MARRËVESHJEN KUADËR PËR LEJEN PRINDËRORE TË REALIZUAR NGA UNICE, CEEP DHE ETUC”

3 qershor 1996

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen mbi politikën sociale, shtojcë e Protokollit (Nr. 14) mbi politikën sociale, shtojcë e Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, dhe në veçanti nenin 4 te tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

1. Ndërkohe që mbi bazën e Protokollit mbi politikën sociale, shtetet anëtare, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (tani tutje te referuar si 'Shtete anëtare'), me dëshirën për të ndjekur drejtimin e planifikuar nga Karta Sociale (1989), kanë përfunduar ndërmjet tyre një Marrëveshje mbi politikën sociale;

2. Ndërkohe që punëdhënësit dhe punëmarrësit munden, që në përputhje me nenin 4(2) të Marrëveshjes mbi politikën sociale, të kërkojnë së bashku që marrëveshjet në nivel Komunitar të zbatohen nga një vendim i Këshillit, bazuar në një propozim të Komisionit.

3. Ndërkohe që paragrafi 16 i Kartës së Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve, mbi trajtimin e barabartë për burrat dhe gratë parashikon, ndërmjet të tjerash, që “duhet të merren gjithashtu masa të cilat tu mundësojnë burrave dhe grave të bashkërendojnë detyrimet e tyre familjare dhe ato të punës”;

4. Ndërkohe që Këshilli, pavarësisht ekzistencës së një mirëkuptimi të gjerë, nuk ka qenë në gjendje të veprojë mbi propozimin për një Direktivë mbi lejen e lindjes për arsye familjare, të ndryshuar më pesëmbëdhjete nëntor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër;

5. Ndërkohe që Komisioni, në përputhje me nenin 3(2) të Marrëveshjes mbi politikën sociale, ka këshilluar punëdhënësit dhe punëmarrësit mbi drejtimin e mundshëm të një aksioni Komunitar në lidhje me bashkërendimin e jetës në familje dhe në punë;

6. Ndërkohe që Komisioni, duke konsideruar se pas këtij këshillimi aksioni Komunitar ishte i dëshirueshëm, këshilloi edhe një herë punëdhënësit dhe punëmarrësit mbi thelbin e propozimit të bërë në përputhje me nenin 3 (3) të Marrëveshjes në fjalë;

7. Ndërkohe që organizatat e përgjithshme ndër-industriale (UNICE, CEEP dhe ETUC) kanë informuar Komisionin, me anë të një letre të përbashkët më datë pesë korrik

njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjete e pesë, mbi dëshirën e tyre për të nisur procedurën e parashikuar në nenin 4 të Marrëveshjes në fjalë;

8. Ndërkohë që organizatat e përgjithshme ndër-industriale, arritën më katërmbëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjete e pesë, një marrëveshje kuadër mbi lejen prindërore; ndërkohë që ato ia kanë kaluar kërkesën e tyre të përbashkët Komisionit me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshje kuadër nga një Vendim i Këshillit që e merr nismën nga një propozim i Komisionit, në përputhje me nenin 4(2) të Marrëveshjes në fjalë;

9. Ndërkohë që Këshilli, në Rezolutën e tij të gjashtë dhjetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër “Mbi disa aspekte për një politikë sociale të Bashkimit Evropian; një kontribut në konvergencën ekonomike dhe sociale të Unionit”, i kërkoi të dyja palëve të industrisë të përdorin mundësitë për realizimin e marrëveshjeve, duke qenë se ato janë zakonisht më afër realitetit dhe problemeve sociale;

10. Ndërkohë që në Madrid, anëtarët e Këshillit Evropian nga ato shtete të cilat nënshkruan Marrëveshjen mbi politikën sociale, e mirëpritën realizimin e kësaj marrëveshjeje kuadër.

11. Ndërkohë që palët nënshkruese dëshironin arritjen e një marrëveshjeje kuadër që përcaktonte kërkesat minimale të lejes prindërore dhe periudhën kohore të largimit nga puna për shkak të një force madhore, dhe përcaktimit nga shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësve dhe punëmarrësve për përcaktimin e kushteve nën të cilat do të zbatohet leja prindërore, me qëllim marrjen parasysh të situatës, përfshirë situatën në lidhje me politikën e familjes që ekziston në secilin shtet anëtar, veçanërisht për sa i përket kushteve për dhënien e lejes prindërore dhe ushtrimin e kësaj të drejte.

12. Ndërkohë që instrumenti i duhur për zbatimin e kësaj marrëveshjeje kuadër është një Direktivë, brenda kuptimit të nenit 189 të Traktatit; ndërkohë që ajo është, si pasojë, detyruese për shtetet anëtare përsa i përket rezultatit që duhet të arrihet, por u lejon shteteve të zgjedhin formën dhe metodat;

13. Ndërkohë që, në përputhje me parimin e subsidiaritetit dhe parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 3b të Traktatit, objektivat e kësaj Direktive nuk mund të arrihen në mënyrë të mjaftueshme nga shtetet anëtare dhe mundet, për rrjedhojë, të arrihen më mirë nga Komuniteti; ndërkohë që kjo Direktivë është e kufizuar në minimumin e kërkuar për arritjen e këtyre objektivave dhe nuk shkon përtej çfarë është e nevojshme për të arritur këtë qëllim;

14. Ndërkohë që Komisioni ka hartuar propozimin e tij për një Direktivë duke marrë parasysh statusin përfaqësues të palëve nënshkruese, mandatin e tyre dhe ligjshmërinë e neneve të marrëveshjes kuadër dhe përputhshmërinë me dispozitat përkatëse në lidhje me sipërmarrjet e vogla dhe të mesme;

15. Ndërkohë që Komisioni në përputhje me Njoftimin e tij, të katërmbëdhjetë dhjetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, në lidhje me zbatimin e Protokollit mbi politikën sociale, ka informuar Parlamentin Evropian duke i dërguar tekstin e marrëveshjes kuadër, shoqëruar me propozimin e tij për një Direktivë dhe memorandumun shpjegues.

16. Ndërkohë që Komisioni informoi, gjithashtu, Komitetin Ekonomik dhe Social duke i dërguar tekstin e marrëveshjes kuadër, shoqëruar me propozimin e tij për një Direktivë dhe memorandumun shpjegues.

17. Ndërkohë që pika 2 e nenit 4 të marrëveshjes kuadër përcakton se zbatimi i dispozitave të kësaj marrëveshjeje nuk përben bazë të vlefshme për uljen e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes të ofruar punëtorëve në sferën e kësaj marrëveshjeje. Kjo nuk paragjykon të drejtën e shteteve anëtare dhe/ose të punëdhënësve dhe punëmarrësve për të hartuar dispozita të ndryshme ligjore, rregullatore ose kontraktuale, duke marrë parasysh rrethanat ndryshuese (përfshirë paraqitjen e mos-transferimit), për aq kohë sa këto të jenë në përputhje me kërkesat minimale të parashtruara në këtë marrëveshje.

18. Ndërkohë që Karta e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve njih rëndësinë e luftës kundër çdo forme të diskriminimit, veçanërisht të bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, opinionet dhe besimet.

19. Ndërkohë që neni F (2) i Traktatit mbi Bashkimin Evropian parashikon që “Bashkimi do të respektojë të drejtat themelore, të garantuara nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë në katër nëntor njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë, dhe siç ato rezultojnë nga traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të Ligjit Komunitar”.

20. Ndërkohë që shtetet anëtare mund t'u besojnë punëdhënësve dhe punëmarrësve, me kërkesën e tyre të përbashkët, zbatimin e kësaj Direktive, për aq kohë sa ato të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar se mund të garantojnë në çdo kohë rezultatet e kërkuara nga kjo Direktivë.

21. Ndërkohë që zbatimi i marrëveshjes kuadër kontribuon në arritjen e objektivave sipas nenit 1 të Marrëveshjes mbi Politikën Sociale,

Ka miratuar këtë Direktivë:

Neni 1 **Zbatimi i marrëveshjes kuadër**

Qëllimi i kësaj Direktive është të vërë në zbatim marrëveshjen kuadër shtesë mbi lejen prindërore, të realizuar më katërmbëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë, ndërmjet organizatave të përgjithshme ndër-industriale (UNICE, CEEP dhe ETUC)

Neni 2

Dispozitat përfundimtare

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për përshtatjen me këtë Direktivë deri në tre qershor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë, si afati më i fundit, ose të sigurojnë që brenda kësaj date punëdhënësit dhe punëmarrësit të kenë paraqitur masat e nevojshme nëpërmjet marrëveshjes, për të cilat shteteve anëtare u kërkohet të marrin masat e nevojshme për t'u mundësuar që të jenë, në çdo kohë, në pozitën e garantimit të rezultateve të kërkuara nga kjo Direktivë. Shtetet anëtare do të informojnë menjëherë Komisionin për këto masa.

2. Shtetet anëtare mund të kenë një periudhë shtesë prej maksimumi një vit, nëse kjo është e nevojshme, duke marrë parasysh vështirësitë specifike apo zbatimin e një marrëveshjeje kolektive. Në raste të tilla, Komisioni duhet të njoftohet menjëherë.

3. Kur shtetet anëtare miratojnë masat e referuara në paragrafin 1, ato duhet të përmbajnë një referencë ndaj kësaj Direktive ose të shoqërohet nga një referencë e tillë në rast të publikimit zyrtar të tyre. Metodatat e bërjes së kësaj reference do të përcaktohen nga shtetet anëtare.

Neni 3

Kjo Direktive u adresohet shteteve anëtare.

SHTOJCË

“MARRËVESHJA KUADËR MBI LEJEN PRINDËRORE”

Preambul

Marrëveshja kuadër përfaqëson një nismë të UNICE, CEEP dhe ETUC me qëllim përcaktimin e kërkesave minimale për lejen prindërore dhe periudhën kohore të largimit nga puna për shkak të një force madhore, si mjete të rëndësishme të bashkërendimit të jetës familjare dhe asaj të punës duke nxitur trajtimin dhe mundësitë e barabarta ndërmjet burrave dhe grave.

ETUC, UNICE dhe CEEP i kërkojnë Komisionit që të paraqesë këtë marrëveshje kuadër pranë Këshillit, me qëllim marrjen e një Vendimi të Këshillit, për t'i bërë këto kërkesa minimale të detyrueshme për shtetet anëtare të Komunitetit Evropian, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

I- Konsiderata të Përgjithshme

1. Duke pasur parasysh Marrëveshjen mbi politikën sociale, shtojcë e Protokollit mbi politikën sociale, shtojcë e Traktatit Themelues të Komunitetit, dhe në veçanti nenet 3 (4) dhe 4 (2) të tij;

2. Ndërkohë që neni 4 (2) i Marrëveshjes mbi politikën sociale parashikon që marrëveshjet e realizuara në nivel Komunitar do të zbatohen, me kërkesën e përbashkët të palëve nënshkruese, me një vendim Këshilli bazuar paraprakisht nga një propozim i Komisionit;

3. Ndërkohë që Komisioni ka bërë të ditur qëllimin e tij për të propozuar një masë Komunitare mbi bashkërendimin e jetës në familje dhe në punë;

4. Ndërkohë që Karta e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale përcakton në pikën 16, që ka të bëjë me trajtimin e barabartë, që duhet të merren masa për tu mundësuar burrave dhe grave të bashkërendojnë detyrimet e tyre në punë dhe ato në familje;

5. Ndërkohë që Rezoluta e Këshillit, e gjashtë dhjetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër, pranon se një politikë efektive e mundësive të barabarta nënkupton një strategji të përgjithshme të integruar duke lejuar një organizim më të mirë të orëve të punës, fleksibilitet më të madh si dhe një rikthim më të lehtë në jetën e punës, dhe vëren rolin e rëndësishëm të dy palëve të industrisë në këtë fushë duke i ofruar si burrave ashtu edhe grave një mundësi për bashkërendimin e përgjegjësive të tyre në punë dhe detyrimeve familjare;

6. Ndërkohë që masat për bashkërendimin e jetës në familje dhe në punë, duhet të inkurajojnë përfshirjen e mënyrave të reja fleksibile të organizimit të punës dhe kohës për t'ju përshtatur më mirë nevojave në ndryshim të shoqërisë dhe të cilat duhet të marrin parasysh nevojat e të dyja palëve, sipërmarrësve dhe punëtorëve;

7. Ndërkohë që politika e familjes duhet të shikohet në kontekstin e ndryshimeve demografike, efekteve të popullsisë në plakje, në mënjanimin e ndryshimeve midis brezave dhe në nxitjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.

8. Ndërkohë që burrat duhet të inkurajohen të marrin përsipër një pjesë të barabartë të përgjegjësive familjare, si për shembull, të inkurajohen të marrin lejen prindërore si pjesë e programeve ndërgjegjësuese.

9. Ndërkohë që kjo marrëveshje është një marrëveshje kuadër që përcakton dispozitat dhe kërkesat minimale për lejen prindërore, e ndryshme nga leja e lindjes, dhe periudhën kohore të largimit nga puna për shkak të një force madhore dhe lënien në kompetencë të shteteve anëtare dhe partnerëve sociale për krijimin e kushteve të aksesit dhe rregullave të veçanta të zbatimit, me qëllim që të merret në konsideratë situata në secilin vend anëtar;

10. Ndërkohë që shtetet anëtare duhet të parashikojnë ruajtjen e të drejtave për të përfituar nga sigurimi shëndetësor, gjatë gjithë periudhës minimale të lejes prindërore;

11. Ndërkohë që shtetet anëtare duhet gjithashtu, kur është e përshtatshme sipas kushteve kombëtare dhe duke marrë parasysh situatën buxhetore, të marrin në konsideratë ruajtjen e të drejtave për përfitimet që rrjedhin nga sigurimet shoqërore gjatë gjithë periudhës minimale të lejes prindërore;

12. Ndërkohë që kjo marrëveshje merr parasysh nevojën për të përmirësuar kërkesat e politikës sociale, për të rritur konkurrencën e ekonomisë të Komunitetit dhe për të mënjeluar vendosjen e detyrimeve administrative, financiare dhe ligjore në atë mënyrë që mund të pengojnë krijimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

13. Ndërkohë që organet e punëdhënësve dhe punëmarrësve janë vendi më i mirë për gjetjen e zgjidhjeve të cilat i përshtaten nevojave të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe duhet, si rrjedhojë, që tu akordohet atyre një rol i veçantë në zbatimin e kësaj marrëveshje,

Palët nënshkruese kanë rënë dakord si më poshtë:

II. Përmbajtja

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Kjo marrëveshje përcakton kërkesat minimale të parashikuara për lehtësimin e bashkërendimit të përgjegjësive prindërore dhe profesionale për prindërit që punojnë.

2. Kjo marrëveshje zbatohet për të gjithë punëtorët, burra dhe gra, të cilët kanë një kontratë pune ose marrëdhënie punësimi siç përcaktohet nga ligji, marrëveshjet kolektive ose praktika që është në fuqi në secilin shtet anëtar.

Neni 2

Leja prindërore

1. Kjo marrëveshje u jep, duke iu nënshtruar nenit 2.2, punëtorëve burra dhe gra një të drejtë individuale për lejen prindërore në rast lindjeje ose birësimi të një fëmije për t'u dhënë mundësi atyre që të kujdesen për fëmijën, për të paktën tre muaj, deri në një moshë maksimale deri në tetë vjeç, të përcaktuar nga shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit.

2. Për të nxitur mundësi dhe trajtim të barabartë midis burrave dhe grave, palët e kësaj marrëveshje konsiderojnë se e drejta për këtë leje prindërore, e parashikuar në nenin 2.1, duhet të jepet mbi një bazë jo të transferueshme.

3. Kushtet e aksesit dhe rregullat specifike për të zbatuar lejen prindërore do të përcaktohen nga ligji dhe/ose marrëveshja kolektive në shtetet anëtare, për aq kohë sa respektohen kërkesat minimale të kësaj marrëveshjeje. Shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit mundën, në veçanti:

a. të vendosin nëse leja prindërore është dhënë e plotë apo e pjesshme, në mënyrë të ndërprerë apo në formën e një sistemi kreditimi kohor.

b. të bëjë të mundur dhënien e të drejtës së lejes prindërore, që i nënshtrohet një periudhe kualifikimi pune dhe/ose një kohëzgjatje të kualifikimit të shërbimit, e cila nuk duhet të kalojë periudhën një vjeçare;

c. të përshtatin kushtet e aksesit dhe rregullat e veçanta për të zbatuar lejen prindërore për raste të veçanta të birësimit;

d. të vendosin periudha njoftimi ku vetë punëmarrësit të njoftojnë punëdhënësin mbi kohën e ushtrimit të lejes prindërore, duke përcaktuar fillimin dhe fundin e periudhës së lejes.

e. të përcaktojnë rrethanat në të cilat një punëdhënës, pas këshillimit në përputhje me legjislacionin kombëtar, praktikatat dhe marrëveshjet kolektive, lejohet të shtyjë dhënien e lejes prindërore për arsye të justifikueshme që kanë lidhje me aktivitetin e sipërmarrjes (p.sh. kur puna është e një natyre sezonale, kur zëvendësimi nuk mund të bëhet brenda periudhës së njoftimit, kur një numër i konsiderueshëm punëtorësh kërkojnë leje prindërore në të njëjtën kohë, kur një funksion i veçantë është i një rëndësie strategjike). Çdo problem që del nga zbatimi i kësaj dispozite do të trajtohet në përputhje me legjislacionin kombëtar, praktikatat dhe marrëveshjet kolektive;

f. Përveç pikës (e), të autorizojnë rregullime të veçanta për përmbushjen e kërkesave operacionale dhe organizative të sipërmarrjeve të vogla.

4. Me qëllim për të siguruar që punëtorët të mund të ushtrojnë të drejtën e lejes prindërore, shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit do të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur punëtorët nga pushimi nga puna për shkak të një kërkesë për/ apo marrje të lejes prindërore në përputhje me legjislacionin kombëtar, praktikatat dhe marrëveshjet kolektive.

5. Në fund të lejes prindërore, punëtorët kanë të drejtë të kthehen në të njëjtin vend pune, dhe nëse kjo është e pamundur, në një vend ekuivalent ose të ngjashëm pune në përputhje me kontratën e punësimit ose marrëdhënien e punësimit.

6. Të drejtat e përfituara apo që janë në procesin e përfitimit të tyre nga ana e punëtorit, në datën në të cilën fillon leja prindërore, duhet të vazhdojnë deri në fund të lejes prindërore. Në fund të lejes prindërore do të zbatohen këto të drejta, përfshirë këtu ndryshimet që mund të vijnë nga legjislacioni kombëtar, praktikatat dhe marrëveshjet kolektive.

7. Shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit do të përcaktojnë statusin e kontratës së punësimit apo marrëveshjes së punësimit për periudhën e lejes prindërore.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me sigurimin shoqëror përsa i përket kësaj marrëveshje, merren në konsideratë dhe përcaktohen nga shtetet anëtare në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke marrë parasysh rëndësinë e vazhdimit të gëzimit të sigurimit shoqëror brenda skemave të ndryshme, në veçanti të sigurimit shëndetësor.

Neni 3

Periudha e largimit nga puna në rastin e një force madhore

1. Shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit do të marrin masat e nevojshme për tu dhënë të drejtën punëtorëve për largimin nga puna në rast force madhore, në përputhje me legjislacionin kombëtar, marrëveshjet kolektive dhe/ose praktikatat, për arsye urgjente familjare në rast sëmundjeje ose aksidenti ku prania e menjëhershme e punëtorit është jetësore.

2. Shtetet anëtare dhe/ose punëdhënësit dhe punëmarrësit mund të përcaktojnë kushtet e aksesit dhe rregullat e veçanta për zbatimin e nenit 3.1 dhe të kufizojnë këtë të drejtë për një periudhë të caktuar kohore vjetore dhe /ose sipas rastit.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Shtetet anëtare mund të zbatojnë apo të paraqesin dispozita më të favorshme sesa ato të parashtruara në këtë marrëveshje.

2. Zbatimi i dispozitave të kësaj marrëveshjeje nuk do të përbëjë arsye të vlefshme për uljen e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes akorduar punëtorëve në fushën e mbuluar nga kjo marrëveshje. Kjo nuk paragjykon të drejtën e shteteve anëtare dhe/ose të punëdhënësve dhe punëmarrësve për të hartuar dispozita të ndryshme ligjore, rregullatore apo kontraktuale, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave (përfshirë paraqitjen e mos -transferimit), për aq kohë sa këto të jenë në përputhje me kërkesat minimale të parashtruara në këtë marrëveshje.

3. Kjo Marrëveshje nuk paragjykon të drejtën e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të hartuar, në një nivel të caktuar përfshirë dhe atë evropian, marrëveshjet që adoptojnë dhe/ose plotësojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje, me qëllim marrjen në konsideratë të rrethanave të veçanta.

4. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me vendimin e Këshillit, brenda një periudhe kohore dy vjeçare që nga miratimi i tij, ose do të sigurojnë që punëdhënësit dhe punëmarrësit të

paraqesin masat e nevojshme, me anë të marrëveshjes, përpara përfundimit të kësaj periudhe. Shtetet anëtare mund, nëse është e nevojshme të merren parasysh vështirësitë e veçanta apo zbatimi i marrëveshjeve kolektive, të kenë maksimumi deri në një vit kohë më shumë për të vepruar në përputhje me këtë vendim.

5. Parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve që vijnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar, praktikatat dhe marrëveshjet kolektive.

6. Pa cenuar rolin përkatës të Komisionit, gjykatave kombëtare, dhe Gjykatës së Drejtësisë, çdo çështje që lidhet me interpretimin e kësaj marrëveshjeje në nivel evropian duhet, në radhë të parë, të referohet nga Komisioni palëve nënshkruese që do japin një opinion.

7. Palët nënshkruese do të rishikojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, pesë vjet pas datës së vendimit të Këshillit, nëse kjo kërkohet nga një nga palët nënshkruese në këtë marrëveshje.